

Data 26.08.2022

**STATUTI I SHOQERISE DHE AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ Start Moving ” SH.P.K**

Shtetasi:

Ornela Gaçe e lindur me 08.05.1979 ne Tirane , me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit H95508051J madhore me zotesi te plote per te vepruar, krijon Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ Start Moving ” SH.P.K , me seli ne Rruga Mihal Grameno, Pallati nr 8, Shkalla nr 2, Apartamenti nr 22, Tirane .Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare “Start Moving” SH.P.K si dhe Zhvillimi i metejshem i saj.

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1.1 Ortaku i vetem i shoqerise eshte Ornela Gaçe e lindur me 08.05.1979 ne Tirane , me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit H95508051J madhore me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoterne 100% te kapitalit te shoqerise.

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

2.1. Shoqeria mban emrin “ Start Moving ” SH.P.K dhe eshte person juridik shqiptar.

Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit .

2.2 Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontratat respektive.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

3.1. Shoqeria "" **Start Moving**" SH.P.K, e ka qendren "Rruga Mihal Grameno, Pallati nr 8, Shkalla nr 2, Apartamenti nr 22, Tirane" dhe gezon te drejten per te hapur dege dhe zyra te perfaqesimit te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

3.2 Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

4.1. Objekti i Veprimtarise se Shoqerise eshte: Agjenci eventesh. Marketing tregu dhe konsulenca financiare, Stenda, tavolina dhe karrige me qera per evente te ndryshme.

4.2. Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortaku i vetem i saj.

4.3. Shoqeria mund te zgjeroje ose kufizoje fushen e veprimtarise se saj ne cdo moment sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 5

PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM

5.1. Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakut te vetem.

5.2. Ortaku i vetem qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, pertej kapitalit themelitar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

NENI 6

KOHEZGJATJA

6.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj.

NENI 7

SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "Start Moving " SH.P.K

KREU II

NENI 8

KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "" Start Moving" SH.P.K , eshte 100 000 (Njeqind mije) leke i cili perbehet nga:

- 8.1. Kapitali para me vlere te barabarte me 100 000 (Njeqind mije) leke
- 8.2. Kuotat e shoqerise do te ndahen ne nje kuote te vetme,te cilat do te zoterohen 100% nga ortakut i vetem i shoqerise.

Ortaku i vetem i shoqerise eshte Ornella Gaçe e lindur me 08.05.1979 ne Tirane , me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit H95508051J madhore me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.

8.3. Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku i Vetem ne favor te te treteve, kryhet gjithnje me akt noterial te posacem.

9.2. Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 100 000 (Njeqind mije) leke. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakut te shoqerise dlle sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve dhe pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- p) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga rasti i kalimit të kuotave, deri në rastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "dhe ndryshimeve të mëvonshme Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre nga ortakët e tjerë të shoqërisë.

KREU III

NENI 11

ORGANI VENDIMARRËS

11.1. Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

11.2. Ortaku i Vetëm, vendos për shoqërinë si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- p) mbikëqijjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursive së veprimtarisë;
- d) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- f) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj
- g) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë dhe riorganizimin dhe prishjen

eshoqerise etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem duhet te regjistrohen në regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

ADMINISTRATORI

12.1. Administrator i shoqerise eshte Ornela Gaçe.

12.2. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".Administratori i shoqerise mund te caktohet edhe nje person tjeter, jashta orakeve.

NENI 13

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë,

ç) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut të Vetem.

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligj për Qendrën Kombëtare të Biznesit ;

e) raportojë përpara Ortakut të Vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

13.2. Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

13.3. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

13.4. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI15

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme, e perbere nga Ortaku i Vetem miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e perbere nga Ortaku i vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

MBARIMI I SHOQERISE

16.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themehmin e saj;
- b) rre vendim të Ortakut te Vetem ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit ";
- d) me vendim të gjykatës;

16.2. Ne kete rast, Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim qe parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

17.1. Transformimi i shoqerise behet me vendim te Ortakut te Vetem ose kur ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi eshte paraqitur nje raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

17.2. Çdo transformim i bere ne kundërshtim me kete nen eshte i pavlefshem.

NENI 18

BAZA LIGJORE

18.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dale ne zbatim te tyre ne Republiken e Shqiperise.

NENI 19

MOSMARREVESHJET

19.1. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindin ne Shoqerise dhe te tereve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

19.2. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane,

NENI 20

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

20.1. Ky statut eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te Ortakut te Vetem dhe eshte nenshkruar prej tij.

Neni 21

Klauzole mbyllese

20.1 Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKET THEMELUES

" Start Moving " SH.P.K

Ornela Gaçe

Ornela Gaçe
